



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 10, DATË 23 / 07 / 2024

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR SHTYRJE TË AFATIT TË STATUSIT
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR
PROJEKTIN E INVESTIMIT “DRYMADES BEACH RESORT” ME SUBJEKT
APLIKUES BLUE BAY SHPK, NUIS L92222038S**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 18 dhe nenit 21 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu I, pika 3/c të VKM-së Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi”, Kreu II, pika 8 të VKM-së Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Komiteti i Investimeve Strategjike me Vendimin Nr. 7/6, datë 15.07.2021, vendosi miratimin e statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “Drymades Beach Resort” propozuar nga subjekti "Blue Bay sh.p.k" me NUIS L92222038S.
- Projekti parashikonte ndërtimin e 1 (një) hoteli elitare të standardit me 5 yje me 110 hapësira akomoduese dhe parashikonte të punësonte 165 persona.
- Subjekti “Bluebay sh.p.k” ishte pajisur me leje zhvillimore Nr.prot 563/1, datë 10.03.2021 e miratuar me Vendimin e KKT Nr. 25, datë 14.10.2020, me vendndodhje Bashkia Himarë.
- Projektit “Drymades Beach Resort” iu miratua statusi “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

- Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht neni 21, neni 24 dhe neni 29 i Ligjit Nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, masat mbështetëse të miratuara për këtë projekt janë si më poshtë vijon:
 - a) Kryerja e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
 - b) Asistencë në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike;
 - c) Akses në infrastrukturë mbështetëse në bazë të legjislacioneve sektoriale.

- Referuar Raportit Teknik mbi ecurinë e punimeve të vendosur në dispozicion nga subjekti “Blue Bay shpk”, konstatohet se objekti ndodhet në fazën e zbatimit të punimeve të muraturës së tullës dhe ka përfunduar tërësisht ndërtimi i strukturës së karabinasë së objektit “Drymades Beach Resort”, miratuar me leje ndërtimi Nr. 39, nr. 832/1 prot., datë 17.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe vendimin Nr.130, prot. 3460/1 datë 08.11.2023, për miratimin e shtyrjes së afatit të lejes së ndërtimit për projektin “Drymades Beach Resort”.

Komiteti i Investimeve Strategjike, duke pasur parasysh të gjithë historikun e shqyrtimit dhe miratimit të projektit të investimit në fjalë, komunikimeve me subjektin, si edhe duke vlerësuar se masa mbështetëse akses në infrastrukturë nuk kushtëzohet nga statusi “Investim/ Investitor Strategjik, Procedurë e Asistuar”, pasi është një drejtë që përfitohet nga legjislacionet sektoriale, çmoi se nuk ka një arsyetim të mjtueshëm për shtyrjen e afatit të projektit “Drymades Beach Resort”.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për shtyrjen e afatit të Statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e asistuar” për projektin e investimit strategjik “Drymades Beach Resort, i cili realizohet nga subjekti “Blue Bay sh.p.k” me NUIS L92222038S.
2. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet investitorit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

ERVIN METE

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
LAURA PLAKU (SARO)